



**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PRIVREMENA INSTITUCIJA SAMOUPRAVE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT**

**QEVERIA E KOSOVËS / MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
VLADA KOSOVA / MINISTARSTVO LOKALNE ADMINISTRACIJE
GOVERNMENT OF KOSOVO/MINISTRY OF LOCAL GOVERNMENT ADMINISTRATION**

Në pajtim me Rregulloren e UNMIK 2001/9 “Mbi Kornizën Kushtetuese të Kosovës”, Kreu 5.2, Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/19, “Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë”, Rregulloren e UNMIK-ut 2005/15 “Për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/19 Mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë” Shtojca XIV (iii) (b), (d) dhe (g), me qëllim të zbatimit të ligjit në komuna, Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal nxjerr këtë:

KËSHILLË LIGJORE

Nr. 2007/01 datë 22.01.2007

“Për Procedurën e Ndërprerjes së Marrdhënies së Punës së Kryeshefit Ekzekutiv të Komunës së Vushtrrisë”

I. QËLLIMI I KËSHILLËS LIGJORE

Kjo shkresë ka për qëllim të ofrojë këshilla ligjore që Komuna e Vushtrrisë duhet të ndjekë në lidhje me ndërprerjen e marrdhënies së punës së Kryeshefit Ekzekutiv. Këshillat ligjore bazohet në dispozitat e legjislacionit në fuqi për vetëqeverisjen lokale dhe shërbimin civil në Kosovë.

II. PARASHTRIMI I ÇËSHTJES

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) sipas detyres zyrtare ka marrën në dijeni se Kryeshefi Ekzekutiv i Komunës së Vushtrrisë ka arritur moshën 65 vjeqare dhe i njejtë është duke vazhduar punën e Kryeshefit Ekzekutiv.

III. PARASHTRIMI I FAKTEVE

Aktet ligjore të aplikueshme për këtë rast janë:

- **Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45 ‘Për Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës’**
- **Urdhëresa Administrative 2003/2 “Për Zbatimin e Rregullores 2001/36 Për Shërbimin Civil në Kosovë”**
- **Udhëzimi Administrativ Nr.MSHP/DASHC 2003/06 Procedurat e Ndërprerjes së Mardhënies së Punës.**
- **Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45 ‘Për Vetëqeverisjen e Komunave’**

Neni 34 pika 1 e kësaj rregulloreje parasheh në mënyrë taksative se Shërbimin Civil Administrativ e përbëjnë: Kryeshefi ekzekutiv, Bordi i Drejtorëve dhe personeli administrativ.

- **Urdhëresa Administrative 2003/2 “Për Zbatimin e Rregullores 2001/36 Për Shërbimin Civil në Kosovë.**

Kapitulli IX – Përfundimi i Punësimit neni 35.1 pika (a) parasheh që mosha mandatore e pensionimit të nëpunësit civil është gjashtëdhjetë e pesë vjet (65). Me arritjen e kësaj moshe parashihet që automatikisht t’i përfundoj marrdhënia e punës çdo shërbyesi civil.

- **Udhëzimi Administrativ Nr.MSHP/DASHC 2003/06 Procedurat e Ndërprerjes së Mardhënies së Punës.**

Pika 2 c parasheh procedurën dhe afatin 30 ditor për informimin e shërbyesit civil lidhur me:

1. datën e pensionimit;
2. datën dhe mënyrën e pagesës së pagës së fundit;
3. pushimin vjetor të pashfrytëzuar, gjegjësisht metodën e kompenzimit;
4. aranzhimet për menaxhimin, gjegjësisht pagesën e fondit të akumuluar pensioner;
5. kërkesën për të kthyer çdo pronë të komunës që i punësuari e posedon, deri në ditën e fundit të mardhënies së punës dhe
6. kërkesën për të kthyer lejekalimin e sigurimit në ditën e fundit të punës.

IV. KONKLUZIONET DHE KËSHILLAT PËR ZBATIMIN E LIGJIT

Pas shqyrtimit të dispozitave ligjore në fuqi dhe analizës së çeshtjeve të ngritura nga fillimi mund të nxjerrim konkluzionet e mëposhtme:

1. Rregullorja 2000/45 Mbi Vetëqeverisjen e Komunave ka epërsi mbi Rregulloren 2001/36 Mbi Shërbimin Civil të Kosovës/Urdhëresën Administrative 2003/2 për ato çeshtje që ajo i rregullon shprehimisht dhe hollësisht siç është rasti i shkarkimit të Kryeshefit Ekzekutiv.
2. Procedurat e përfundimit të mardhënies së punës nuk janë paraparë me Rregulloren 2000/45, për këto çeshtje duhen respektuar parimet e përgjithshme të legjislacionit në fuqi për shërbimin civil (Urdhëresa Administrative 2003/2 dhe Udhëzimi Administrativ Nr. MSHP/DASHC 2003/06 Procedurat e Ndërprerjes së Mardhënies së Punës) .
3. Kuvendit komunal të Komunës së Vushtrrisë i propozojmë që deri në përfundimin e procedurave ligjore për pranimin e Kryeshefit të ri, të caktoj Ushtruesin e Detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv.

Prishtinë 22 janar 2007

Lutfi Haziri

Zv. Kryeministër dhe Ministër i Administrimit të Pushteti Lokal